



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.104/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada- Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Dardanë për shkak të vendosjes së flamujve në shtylla elektrike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.104/2017 e dates 06.06.2017, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli Prishtinë

A r s y e t i m

Me datën 06.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 05.06.2017 në rrugën “Skenderbeu” në Dardanë, aktivisti i tyre ka vërejtur se nëpër shtylla elektrike ishin vendosur flamujt të Koalicionit PDK-AAK-NISMA.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e Koalicioni PDK-AAK-NISMA, është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, neni 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014, sepse vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Në përgjigjen në ankesë të datës 07.06.2017, Koalicioni PDK-AAK-NISMA thekson se në rastin konkret shkelja nuk egziston sepse në mungesë të hapësirave reklamuese kuvendi komunal i Kamenicës iu ka lejuar përdorimin e hapësirave dhe objekteve publike për reklamim.

Lidhur me përgjigjen në ankesë pala i ka bashkangjitur kopjen e vendimit për lejimin e shfrytëzimit të hapësirave publike si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

ankesa është e pabazuar

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA, nuk është bërë shkelja e nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi që materiali zgjedhor-flamujt e koalicionit PDK-AAK-NISMA, janë të vendosur pikërisht në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të flamujve.

Paneli gjatë shqyrtimit të ankesës mori për bazë pretendimet e theksuara në përgjigje në ankesë nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA, se Kuvendi Komunal i Kamenicës i ka lejuar për shfrytëzim të gjitha partive politike vendosjen e panove reklamuese, fotografive, flamujve partiak në shtyllat publike në rrugën "Skenderbeu" në Kamenicë, dhe se pas përfundimit të fushatës zgjedhore me datë 12.06.2017 të gjitha subjektet politike obligohen të bëjnë largimin e të gjithë flamujve, fotografive të vendosura gjatë fushatës zgjedhore.

Mbi këtë bazë paneli konsideron se koalicioni në fjalë nuk ka kryer shkelje të neni 33 pika (b) të LZP-së dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.104/2017 më datën 07.06.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Zyheri Haziri**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.